


# RAPORT PARAPRAK

## VLERESIM NDIKIMI NE MJEDIS

(Shtojca II, Pika 10, (a))

NDERTIM STRUKTURE: REPART INDUSTRIAL 1 KATE

VENDODHJA E ZONES SE ZHVILLIMIT: RRUGA 'PRINCAT TOPIA', FSHATI SHTODHER, NJESIA ADMINISTRATIVE HELMAS, BASHKIA KAVAJE, RRETHI



ZHVILLUES/INVESTITOR: WORLD FOAM.SH.P.K  
SUBJEKT NDERTUES: ARKAXHIU.SH.P.K

TIRANE / 2015

**Informacion mbi Projektin:**

**Titulli i projektit:** Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (Procedura paraprake)

**Emri i raportit:** REPART INDUSTRIAL 1 KATE

**Investitor:** WORLD FOAM

**Subjekti ndertues:** ARKAXHIU.Sh.p.k

**Bashkeautor:** Ing. Ilir Robo (Eksperti i Certifikuar)

**Data e këtij raporti:**

Tirane , Janar 2015

**Aprovuar:**

\_\_\_\_\_

Ing. Ilir Robo

Vlerësues i Ndikimit ne Mjedis dhe Auditues Mjedisor

Nr. 4 Vendim, Nr. 125 Regj, Date 12.05.2005, Nr.136 Prot

ING. ILIR ROBO  
SPEC. T. MJEDISIT  
Nr. 125 CERTIFIKA

**Tabela e raportit paraprake te VNM:**

1.	TE DHENA TE PERGJITHSHME .....	3
1.1	Përshkrimin e projektit të propozuar: te cilin e kemi përgatitur dhe bashke-emeluar "Përshkrimi i projektit zhvillimit" të gjitha dokumentat me nenzera perkatese te perfshira ne ku përfshihen keto informacione dhe te dhena teknike si: .....	5
1.2	Përshkrim i shkurtër për kapitujt e Raportit paraprak të VNM-se, ku përfshihen:.....	5
2.	NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE .....	7
2.1.	Hyrje.....	7
2.2.	Vlerat ekologjike (flora dhe fauna) .....	8
3.	INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ .....	10
3.1.	Burimet ujore ne rajon .....	10
3.2.	Baseni i Shkumbinit.....	11
3.3.	Zona ne vleresim .....	14
4.	IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTI, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA, .....	15
4.1.	Ndikimet e mundshme mjedisore .....	15
5.	TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTI DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË .....	23
6.	MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN; .....	25
6.1.	Rehabilitimi mjedisit te ndikuar nga ndertimi i objekt banimil .....	25
7.	MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;.....	28
7.1.	Masat zbutese ndaj ndikimit ne mjedis .....	28

8. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).....	33
9. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.....	34



## 1. TE DHENA TE PERGJITHSHME

Ky raport paraprake VNM se bashku me kerkesen dhe dokumentacionit shoqërues nga ana e zhvilluesit World Foam.sh.p.k, do te paraqiten në MM e cila do te percjell dokumentacionin në AKM per marrjen e Vendimit nga AKM per nenshtirimit te procedurave paraprake te VNM per projektin: **Repart Industrial 1 kate**, me vendodhje ne rrugete "Princat Topia, ne Fshatin Shtodher, Bashkia Kavaje, Rrethi Kavaje, Qarku Tirane.

Zhvilluesi World Foam.Sh.p.k, që synon të zbatojë kete projekt qe do te ndertohen sipas Kontrates se Siper marrjes me date 03.04.2015, me subjektin ndertues Arkaxhiu.sh.p.k i pajisur me Licence nr.**NZ-1491/8** me objekt te kontrates se siper marrjes te nje objekti "**Repart Industrial 1 kate**" ne fshatin Shtodher sipas studimit te realizuar nga grupi projektues i kontraktuar nga zhvilluesi/investitori.

Zhvilluesi World Foam.Sh.p.k me subjekt ndertues **Arkaxhiu.Sh.p.k** kerkon te dorezoj kete **RAPORT PARAPRAK TE VNM –se** per miratim me Vendim te AKM te per projektin :

### "Reparti industrial 1 kate"

Rruga "Princat Topia", ne Fshatin Shtodher, Njesia Administrative Helmas, Bashkia Kavaje, Rrethi Kavaje, Qarku Tirane

Ky projekt do te zhvillohet pergjate rruges se brendshme sekondare te fshatit Shtodher, Njesia Administrative Helmas, Bashkise Kavaje, Rrethi Kavaje, Qarku Tirane brenda zones se zhvillimit te ndertimeve dhe zones se urbanizuar. Zgjidhja optimale e projektit te siguron sherbim me teknologji e me sigurim teknik. Mbetjet e ndertimit ne pergjithesi do te grumbullohen gjithashtu me komoditet e me cilesi te larte sigurie gjate fazes se ngarkim – shkarkimit te materialeve te ndertimit nga mjetet e tonazhit te rende.

Ne kete raport teknik po paraqesim nje permbledhje te pjeses teknike te projektit me te dhenat si me poshte:

Ne tabelen e meposhtme jane dhene treguesit kryesore tekniko te projektit ne zhvillim:

Nr rendor	Emerimi i treguesve	Njesia e matjes	Sasia
1.	Siperfaqe e tokes qe zhvillohet	m <sup>2</sup>	7428.0
2.	Siperfaqe e tokes e zene nga struktura	m <sup>2</sup>	3339.6
3.	Numri i Kateve mbi toke	Nr.	1
4.	Numri i Kateve nen toke	Nr.	0
5.	Numri i vend-Parkimeve	ml	1-10.

**Planimetria e vendodhjes se projektit**

Harta e vendodhjes se objektit te propozuar perkundrejt rajonit eshte paraqitur si me poshte.



Harta nr. 1: Harta e pikeimit te veprave sipas koordinatave perkatese

*Koordinatat alimetrike (Gauss-Kruger Zone 4) te Projektit te Propozuar Repart industrial 1 katesh qe do te ndertohet ne fshatin Shtodher, Njesia administrative Helmas, Bashkia Kavaje, Rrethi Kavaje ne pronen me nr.pasurie.131/186, Zona Kadastrale 3427 , jane si me poshte shenuar,*

Objekti	Koordinatat GK	
Pika 1	E: 4380540.46	N: 4560091.52
Pika 2	E: 4380453.21	N: 4560043.60
Pika 3	E: 4380493.48	N: 4559972.95
Pika 4	E: 4380575.20	N: 4560012.89

Projekti ne vleresim (Repart industrial), pjese qe i takon te ndertohet nga subjekti Arkaxhju.Sh.p.k, ne Shtodher, Bashkia Kavaje, Rrethi Kavaje, Qarku Tirane i cili eshte subjekt i kerkesave te nenit 8 te ligjit nr. 10 440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", i ndryshuar, **SHTOJCA II**(Projektet qe i nenshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis),si :

**Pika 10. Prodhime infrastrukturore, nenpika (a) Projekte për zhvillimin e pasunive të patundshme Industriale**

Kerkohej qe ne fazat fillestare te planifikimit te projektit (projeklidesë), paraqet pranë MM, dhe dokumentacionin përkatës, i cili përmban:



**1.1 Përshkrimin e projektit të propozuar, të cilit i kemi përgatitur dhe bashkë-emëruar "Përshkrimi i projektit zhvillimit" të gjitha dokumentat me nenëra përkatëse të përfshira në ku përfshihen këto informacione dhe të dhëna teknike si:**

a) përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar  
b) planimetria e vendndodhjes së projektit ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit;

c) informacioni për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna) që administrojnë territorin ku propozohet projekti;

g) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit

d) përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit ;

dh) informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacioni për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja ;

e) programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;

ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit (Relacioni);

f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

g) informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pra në zonën së projektit (raporti i VNM-së në vlerësim);

gg) informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret (relacioni teknik);

h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre (relacioni teknik);

i) aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj (relacioni teknik);

j) informacioni për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit (Kërkesa e subjektit +dokumentacioni teknik+kontrata).

**1.2 Përshkrim i shkurtër për kapitujt e Raportit paraprak të VNM-së, ku përfshihen:**

Ky raport paraprak i VNM është përgatitur në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjigjësisë e të afatave për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis" ku specifikisht Kreu I (Zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis) si më poshtë sqaruar:

**Fazat e procedurës paraprake të VNM-së:** Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VND) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar dhe kalon në këto faza të njëpasnjëshme:

a) Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruar nga zhvilluesi në Ministrinë e Mjedisit (MM) dhe përcjellja e tyre nga MM-ja në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);

- b) Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera dhe publikimi i kërkesës;
- c) Marrja e vendimit nga AKM-ja, njoftimi i MM-së, institucioneve të konsultuara, si dhe publikimi i vendimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

**Raportin paraprak të VNM-se, ku përfshihen:**

Kapitulli 1: Te dhëna të përgjithshme për projektin

Kapitulli 2: një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me imazhe;

Kapitulli 3: informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Kapitulli 4: një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër; një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pihur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Kapitulli 5: të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësnore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Kapitulli 6: mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe kthimin e tokës bujqësore (në rast se përdorimi ekzistues është i tillë) dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Kapitulli 7: masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Kapitulli 8: ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

Kapitulli 9: certifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së, të specialistit që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.



**2. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE****2.1. Hyrje**

**Histori:** Për herë të parë emri i Kavajës u përmend gjatë shekullit të XV. Asaj kohe Kavaja shkruhesh Kavalje. Kavaja shtrihet dhe në rrugën e njohur tregtar romake Via Egnatia e që vazhdon më pas në Durrës dhe Elbasan. Gjatë shekullit të XVII dhe XVIII Kavaja përjeton një lëvizje të madhe administrative dhe bëhet qendër tregtare. Më pas, qyteti pati dy fish më shumë shtëpi për dalim me Durrësin. Një udhëtar i asaj koheje raportoi se vendi në vitin 1670 kishte 400 shtëpi, 200 shtetore, pazarin si dhe xhaminë, të cilat u ndërtuan në vitet 1561, 1589, 1625 dhe 1652. Që të katërtat u shkatërruan në shekullin e XX, si pasojë, disa nga luftërat e disa nga ndryshimet infrastrukturore. Ka mbetur vetëm Kulla e Orës. Kavaja ishte e njohur për përpunimin e poçerisë, qylymave dhe bakrit. Gjatë regjimit komunist, Kavaja u shndërrua në qytet industrial si dhe qendër e bujqësisë për rajonin e vet. Kavajasit ishin të parët që morën guximin në vitin 1990 ta mposhtin Regjimin Komunist. Në Mars qytetarët e Kavajës demonstuan për Liri dhe Demokraci. Gjatë konfliktit me policin e asaj kohë, humbi jetën një i ri, që sot është shpallur dëshmor i demokracisë dhe që emrin e tij e mban dhe një nga rrugët e kavajës JOSIF BUDO. Familja e aktorit botëror Aleksandër Moisiu, në fillim të shekullit XX njihet si aktori më i mirë në skenën Gjermane dhe Austriake, pra kishin prejardhjen nga Kavaja. Shqiptari i lindur në Trieste, disa herë ka vizituar qytetin e vet, mbase dhe një pjesë të fëmijërisë së vet e kaloi në Durrës. Gjatë regjimit komunist, shtëpia e Aleksandër Moisiut ishte çerdhe e fëmijëve.

**Ekonomia:** Kavaja është një qytet ku rolin kryesor në të ardhurat e luan turizmi, sidomos gjatë periudhës së verës ku mendohet se atë e vizitojnë rreth 400.000 turistë. Të ardhurat e tjera vijnë kryesisht nga bujqësia, kjo e ndikuar shumë nga relievi (fusha e Myzeqesë dhe fusha e Shkumbinit të Sipërm). Industria është pak e zhvilluar dhe është e përqendruar vetëm në nxjerrjen e gazit natyror në Sinaballaj. Pa përmendur këtu edhe të ardhurat që vijnë nga emigrantet.

**Klima:** Qyteti i Kavajës bën pjesë në ZONEN ME KLIME MESDHETARE FUSHORE QENDRORE të vendit tonë. Klima e këtij qyteti dallohet për DIMER TE BUTE me karakteristika të theksuara mesdhetare. Regjimi i reshjeve, si në të gjithë vendin, është mesdhetar, me sasine me të madhe të reshjeve gjatë VJESHTES e DIMRIT.

Afërsia me detin dhe largësia mbi det janë dy arsytet që reshjet bien në formën e shiut. BORE bie pak dhe rralehere. Sasia vjetore e reshjeve qendron ndërmjet 950-1200mm.

Numri i ditëve me reshje leviz nga 85-100 dite.

DIMRI paraqitet i bute me ndikim të fortë DETAR.

TEMPERATURA MESATARE E JANARIT lëkundet nga 6.5° - 7.5° C.

MINIMUMI ABSOLUT i temperaturës lëkundet nga -5° deri -3° C, dhe në dimra të ftohtë ndodh të zbrese në -9° deri -7° C.

Periudha me ngrica është e shkurtër, vrojtohen rreth 15-30 ditë në vit, gjatë të cilave temperatura minimale është 0° C ose zbrit pak nën të.

Periudha e VEGJETACIONIT (temperatura mesatare >10° c) fillon mesafërisht në dekadën e parë të Marsit

dhe vazhdon deri nga fillimi i dekadës së parë të Dhjetorit.


Afërsia me dëftin e ben që në pranverë ngrihja të jetë e ngadaltë, kështu periudha e nevojshme për të kaluar nga temperatura mesatare 7° në 10° C, zgjat 30-40 ditë.

**Transporti:** Në këtë rajon në përgjithësi transporti është publik si dhe privat sipas kërkesave të banorëve të zonës. Kavaja është një rajon i cili lidhet me pjesën të Shqipërisë me anë të rrugës kryesore Interurbane Tirana – Tepelene.

## 2.2. Vlerat ekologjike (flora dhe fauna)

Për sa u përket vlerave ekologjike mund të themi se janë të pakta në këtë zonë, si flora e fauna, ashtu edhe peizazhet turistike, gjithçka që përfaqëson kjo zonë është një zonë e industrializuar.

Kavaja autostrade dhe zona sekondare pas kësaj rruge, ndodhet brenda zonës industriale, e cila është klasifikuar si zonë e industrializuar sipas Masterplanit të vitit 1994.



Lamia biologjike paraqitet e varfër dhe përqendrohet, bimesisa barishtore që lidhet me këtë rajon dhe disa gjatëvë të vegjël, zvarranike e shpend të zakonshëm që nuk paraqesin rëndësi për t'u trajtuar.

### Flora dhe fauna

#### a. Ekosistemet, habitatet

Vendndodhja e zonës ku do të ndërtohet godina magazinë 1 kate është një shesh me karakteristika që i plotëson kushtet për korrë lloj veprimtarie në zonë e cila po zhvillohet me karakter komercial. Për mëtej këtë sheshi gjendet në zonë me bimesi të ulët. Ekosistemi dhe habitatet më të rëndësishëm në këtë zonë bimet barishtore dhe shkurre të lëkundura ku dominancën e kanë lloje të shkollës (*Carpinus sp.*) dhe menafere (*Rubus imbilus*). Vlerësohet bimesi tipike sipas zonave të industrializuara.

h. Perbeje dhe llojet ekzistuese.

**Karakteristika te flores.**

Terreni ku ndodhet objekti eshte ioke me pjerrasi rreth 1-2 grade, e varfer ne mbulesa bimore te ulet takohen kryesisht bimet barshitore si gram (*Agropyrum sp*) *Geranium sp*, *Trifolium Sp*,dhe pa ndonje bimesi me rendesi , te vecante apo te ralle per fu permendur. Vlerat ekonomike dhe ekologjike jane te uleta. Po keshtu te' uleta jane edhe vlerat potenciale rikjuess, sociale e turistike. Ndikimi real eshte mbi mbulesen vegjetative ne sheshin e nderimit, e cila duhet pranuar se nuk demtohet ne' menyre drastike. Por edhe ai ndikim i vogel mbi mjedisin me masat reabilituese pas perfundimit te aktivitetit ky dem eshte i rparueshem.

**Karakteristikat e faunes.**

Ja ne potencialet tsunistike ku vihet re ndikimi komercial. Nga bisedat me banoret per rreth dhe vezhgimet tone, kjo zone eshte e varfer ne lloje shtazore edhe gjate stineve te fjera te vitit.

Ndikimet negative mbi faunen eshte i ndryshme mbi lloje te ndryshme. Llojet qe ndikohen me shume jane ato te klases se zverranikeve.Takohen me dendur lloje te zverranikeve si hardhuca e mureve (*Lacerta muralis*), zhapiku (*Lacerta viridis*), gjarpëriji (*Vipera amodytes*, *Elaphe longissima etj*) dhe breshkat (*Testudo hermani*) ne kopshtet e shtepive individuale. Bregtesit nuk kane' permasje te vecante. *Acrofauna* paraqitet me popullate te dobësuar e qe me shume bien ne sy shpendet karakterstik te zonave komerciale si harebelat, trumcakat, pellumbat e eger dhe mellenjat me ralle qe mudi te vijne nga prezenca e zonave kordinacore ne distanca te largeta. Grabitqaret si fshkonjte jane' kalimtare te ralle. Kjo berafauna" ndikohet vetem nga zhurmst prandaj prezenca e tyre eshte e ralle.

Perdorimi i biodiversitetit: Elementet qe lidhen me biodiversitetin nuk jane perdorur ne menyre te planifikuar ose per qellime te vecanta nga subjekte te ndryshem, qofte edhe per bime mjeksore pasi zona eshte e zhveshur.



### 3. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

#### 3.1. Burimet ujore ne rajon

Kavaja eshte nje qytet i ndertuar ne ultesiren bregdetare, qe shtrihet ne jug te gjirit te Durresit dhe te Shkombit te Kavajes(Petra) mbi nje fushe te lagur nga dy lumenj te vegjel, Darçi ne Jug dhe Leshniqe ne Veri.

Koordinatat gjeografike (mesatare) te qytetit jane:

-gjoresia gjeografike.....41° 10'

-gjatesia gjeografike.....19° 35'

Rrethi Kavaja karakterizohet nga bregdeti i Kavajes dhe plazhet e tij. Vija bregdetare e Kavajes ka nje gjatesi prej 34-35 km dhe permban nje larmi te madhe plazhesh, ranor, shkembor, me zali, te zhveshur, te gjelber, etj. Ajo ka gjithashtu, nje flore dhe faune te pasur ne toka dhe ne det. Plazhi i Golemit, i dyti per nga madhesia, pas alij te Durresit, nis nga Shkembii i Kavajes dhe perfundon tek derdhja e perroit te Leshniqes, ne nje gjatesi prej 5 kilometra. Ka rere te pastert, te bardhe, e cila, se bashku me gjelberimin e perhershem te pishave dhe kaltesine e detit, krijon nje harmoni tregjyresh mjaft terhoqas e shlodhes. Brazi mbrojtës i pyllit me pisha (Pinus halapensis dhe Pinus pinea) te mbjellura nga njeriu, ka krijuar nje mjedis pyll mjaft funksional prej 205 ha, i cili i rrit shume vlerat ketij plazhi. Fauna e gjalleron ketë zone, me elementet e dunave dhe te pyllit. Nder me te permendurit jane lepuri i eger, nuse lala, bretkosa e zakonshme, breshka e zakonshme, ndersa ne pyll rriten qukapiku, laraska, bilbili, gjelza pikaloshë, etj. Plazhi i Karpenit, ne jug te Golemit, nis nga derdhja e perroit te Dracit dhe arrii derti ne kodrat e Karpenit, ne nje gjatesi 1,5 km. Nuk eshte i gjelber. Fusha perreth eshte e kripezuar dhe ka nje faune tipike baltovine, me pak shpende si; bishtetundesi i bardhe, drenja e fushos, vraponjesi gushbardhe, sqepollci i xunktheve, dallandyshja e debti etj. Duke qene 8 km. larg nga ruga automobilistike eshte pak i frekuentueshem, ndersa qe vitet e fundit ne kodrat prane detit jane ndertuar disa vila tip alpine. Plazhi i Carinos (i Bagose) shtrihet ne qender te gjirit me te njejtin emer, qe fillon nga kodrat e Karpenit deri tek kepi i Lagjit. Eshte nje plazh me rere te bardhe dhe te pastert, me kodra te zhveshura, qe e bejne ate nje plazh te vetmuar me flore e faune te varfer. Bardhori, ka nje vije plazhi prej 5-6 km gjatesi, me gjelberim te perhershem, me dafina e mare, duke krijuar disa variacione me rere, gure apo dhe shkembor. Uji ne bregdet eshte i pastert dhe mjaft i thelle. Parashikohet nderimi i vilave turistike 2-3 kateshe te frekuentuara si nga deti ashtu dhe nga toka. Ujrat jane mjaft te pasur me peshq si levreke, koca, karkalec, etj. Rruga automobilistike prej 10 km. nga qyteti i Kavajes e bejne konkruense me Rivieren e Jonit, duke e konsideruar "peria e Adriatikut". Plazhi i Spillos dhe Grethit, ne nje gjatesi te perbashket prej 8 km. nis nga Guri i Lamuar e perfundon ne grykderdhjen e lumit Shkumbin. Rera eshte e pastert dhe e emet, pershkuar nga disa duna e nje brez morqtes pyjor. Eshte mjaft i pershtatshem per gjuetine e pashkut e te shpendeve te egra ku vecohen rosa, pulbardha, calka, etj. Parashikohet te zhvillohet si zone turistike familjare, duke mundesuar ngritjen e fshatrave, apo hoteleve komode, qe mund te frekuentohen si nepermjet muges tokesore, ashtu dhe detare nga Italia. Plazhi i Gjenralit, ka nje gjatesi 5-6 km, eshte pak i njohur nga turistet dhe ka gjelberim te perhershem, uje te pastert e te thollo. Emrin e ka trasheguar nga nje gjeneral italian qe vinte per pushime gjate vileve 1930-1936. Zona renore ka gjatesi 400 metra e gjeresi 50 m. duke perfunduar me shkombinj natyralo qe zhyten ne det.

### 3.2. Baseni i Shkumbinit

Lumi Shkumbin me pellgun e tij ujembledhes shtrihet ne pjesen qendrore te territorit hidrografik te vendit dhe paraqet interes te vecante ne aspektin e shfrytezimit energjetik, pasi ndodhet larg burimeve hidroenergjetike.

Lumi Shkumbin e ka zanafillen nga faqet Veri-Lindore te malit te Valamares (kuota 2374.4 m absolute) ku shfaqen nje seri burime e liqene karstike, ujrat e te cilave formojne duke rrjedhur ne drejtim Veri-Lindje perroit e Shullerit. Me poshte ai merr edhe ujrat e nje perroi tjetër, qe ushqehet gjithashtu nga nje seri burimesh karstike dhe bashkohet me keto prane pyllit te Sharres. Duke rrjedhur ne drejtim Lindor me emrin Shkumbin ai formon nje lume me rrjedhje ujore te vazhdueshme gjate gjithë vitit.

Pasi len ne te djathte pyllin dhe mullirin e Sharres ai formon nje bryl me shtrate qe rrjedh nga Jug-Lindja ne Veri-Perendim. Ne keto zone te rrjedhjes se tij Shkumbini merr ujrat e disa perrenj ve te rëndësishem si te perroit te Lienges ne te majte dhe te perroit te Gurit te Topit (kuota 2120.1 m absolute), te Gurit te Bardhe (kuota 1535 m absolute), te perroit te Shpelles (kuota 1978.8 m absolute) dhe perroit te Bishnices (kuota 2055.0 m absolute) ne te majte.

Pikerisht ketu ku lumi Shkumbin merr ujrat e Perroit te Bishnices nen kuotan 684.0 m absolute eshte menduar te ndertohet vepra e marjes se hidrocentralit mbi lumin Shkumbin. Nga pikpamja hidrografike sektori i lumit Shkumbin qe pershkruam i perket rrjedhjes se sipërme te lumit Shkumbin, i cili shtrihet deri ne Qukes.

Nje interes tjetër te vecante per qellime te shfrytezimit enegjetik paraqet lumi i Dushes, qe perfaqeson degen me me ujeshteri te lumit Shkumbin ne rrjedhjen e sipërme te tij.

Lumi i Dushes e ka zanafillen nga faqet Veriore te kreshtave malore te Nices (1687.0 m absolute), te majes se Qemerit (1652.0 m absolute) dhe majes se Ribanit (1589.0 m absolute). Perrenjte e tij ushqehet nga nje seri burimesh me uje me prurje, qe nuk i kalojne 10-20 litra/sek., te cilat drejtohen nga Jugu ne drejtim te Veriut sic jane perroi i Dallishlit dhe perroi i Kalivacit me uje gjate gjithë perudhes se vitit.

#### **Karakteristikat e pergjithshme morfometrike**

Lumi Shkumbin deri ne profilin e ures automobilistike qe lidh Proptishtin me Trebinjen ka nje siperfaqe te pergjithshme prej  $F = 199.2 \text{ km}^2$  dhe nje lartesi mesatare te pellgut ujembledhes prej 1258.6 m mbi nivelin e detit. Nga majat e malit te Valamares e deri tek ura e Silabinjes ai ka nje gjatesi  $L = 27.5 \text{ km}$ . Pjerrësia e shpateve rezulton  $I_p = 360 \text{ ‰}$ , ndersa pjerrësia e shtrati te lumit (mesatare e penderuar)  $I_L = 57 \text{ ‰}$  cka tregon per karakterin e theksuar malor te tij dhe per fregues mjaft te larte te energjise se relevelit qe ofron ky lum ne rrjedhjen e sipërme te tij.

#### **Kushtet hidrogeologjike**

Sektori i siperm i pellgut te lumit Shkumbin nga zanafilla e tij (Mali i Valamares) e deri ne Qukes, karakterizohet nga shtresa me ujembajtje te ndryshme. Shkembinjte e shpateve te malit te Valamares perfaqesohen nga shkembinj te care me ujembajtje lokale dhe rezerva te kufizuara deri ne mesatare te ujrave nentokesore, qe gjejne perhapje edhe ne pellgun e perroit te Graboves dhe Verbes (pellgu i Devollit). Keto formacione perbehen kryesisht nga shkembinj intruziv-ultrabazik ( $G_{U_2-3}$ ).

Pasi kalon pyllin dhe mullirin e Sharres, Shkumbini kalon ne kontaktin e gelqeroreve shtresora masive dhe shume te karstezuar (Cr) ne te majte dhe formacione shkembore te care me ujembajtje lokale dhe rezerva te kufizuara te ujrave nentokesore (pellgu i Lienges), qe karakterizohet nga formacione te shkrufta (alevrolite, ranore, mengele dhe pak gelqerore e flishe) ( $Pg_{2-3}$ ). Para dhe pas derdhjes se perroit te Bishnices ai futet ndermjet formacioneve gelqerore (Cr), pikerisht ketu buron nje burim karstik



per te kaluar pastaj ndermjet formacioneve konglomerate me pak ranore e alevrolite (N<sub>142</sub>) deri ne bashkim me lumin Dushnes ne kuoten 533.9 m absolute.

Me keto formacione karakterizohet i gjithë pellgu i lumit te Dushnes (N<sub>142</sub>) te cilat perfaqesojne shtresa me perhapje te gjere dhe ujembajtje mesatare deri ne te vogel.

#### ***Njohurite hidrometrike***

Njohurite hidrometrike ne pellgun e lumit Shkumbin e kane zanafillen me organizimin e sherbimit hidrometeorologjik ne territorin hidrografik te vendit ne vitin 1948.

Ne rrjedhen e mesme te Shkumbinit ka funksionuar qe ne vitin 1949 vendmatja hidrometrike ne lumin Shkumbin Murrash e cila per gjithë pellgun e lumit Shkumbin ka sherbyer si vendmatje referi, mbi bazen e te dhenave te te cilit analizohej veprimtaria hidrometrike ne gjithë pellgun e ketj lumi.

Ne sektorin e siperm te lumit Shkumbin ku shtrihet edhe pelgu ujembledhes i hidrocentralit ne studim ka funksionuar qe nga viti 1961 vendmatja hidrometrike e lumit Shkumbin-Qukes, ndersa ne vitin 1970 vendmatja hidrometrike mbi lumin Shkumbin tek Ura Sllabinje.

Ne kete sektor gjithashtu kane funksionuar edhe dy vendmatje hidrometrike ne Perroin e Radines ne Stravaj (1974) dhe Zalli i Torres (1974).

Per gjithë periudhen e funksionimit te ketyre vendmatjeve jane realizuar deri ne vitin 1985 varesit e formes  $Q=f(H)$  dhe jane percaktuar prurjet mesatare ditore, mujore dhe vjetore te cilat kane bere te mundur te percaktohen prurjet mesatare mujore, vjetore te periudhes se vrojtimeve dhe zgjatjen e serive vjetore te prurjeve ne periudhen 1949-1985 dhe 1964-1985 duke shfrytezuar per kete qellim varesine analitike te formes:

$$y = ax \pm b$$

ku:

y - prurja mesatare vjetore me seri te shkurter vrojtimi

x - prurja mesatare vjetore e vendmatjes me seri te gjate vrojtimi (Shkumbin - Murrash).

#### **Akuiferi ujembajtës kuaternar i Elbasanit**

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është rreth 1250 L/sek, për furnizimin e qytetit të Elbasanit me ujë të pijshëm kryesisht nga Krasta e Madhe dhe Krasta e Vogël dhe për industrinë metalurgjike nga zona e Vidhasit etj. Koeficienti i shfrytëzimit është  $K=0.25-0.3$ . Risku i ndotjes është i lartë për shkak të mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujembajtëse, sidomos në Krastën e Madhe dhe të Vogël, popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare në të 2 Krastat dhe shkarkimeve industriale në zonën e Vidhasit. Monitorimi i cilësisë së ujërave është kryer në zonat më të rëndësishme për qëllime furnizimi me ujë të pijshëm dhe industrial në zonën Krastë e Madhe, Krastë e Vogël dhe Vidhas. Monitorimi i cilësisë bëhet në këto zona për vetë kushtet specifike që kanë: Në zonën Krastë e Madhe e Krastë e Vogël trashësia e mbulesës së mbrojtëse të shtresës ujembajtëse është e vogël ose mungon fare. Gjithë zona është populluar pa respektuar zonat e mbrojtjes sanitare. Në zonën Vidhas, me rivënie në punë të industrisë metalurgjike, merzihet prishja e cilësisë së UN nga shkarkimet industriale. Mundësi ndotje paraqet dhe plënërimi intensiv i tokave bujqësore. Temperatura e ujit është  $T= 14.5-16.5$  gradë Celsius (norma 8-15, deri 20). pH i ujërave, varion nga 7.65-7.92 sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës (Ph = 6.5-8.5). Sipas vlerës së pH (përqendrimi i jonit të hidrogjenit) janë ujëra të tipit alkalin të dobët me pH = 7-9. Vlerat mesatare të pH për vitet 2007-2011 variojnë 7.72-7.8. Mineralizimi i përgjithshëm varion  $Mp=360.23-619.55$  mg/l. Janë brenda normës së lejuar. Mineralizimi i përgjithshëm ka luhate nga 4-46.68 mg/l në dy fazat e monitorimit. Uj është i tipit hidro-karbonat-kalcium-magnezi.

Mineralizimi i përgjithshëm është paraqitur grafikisht për vitet 2007-2011 fig. nr.21. trendi i përgjithshëm nuk ka rritje të madhe. Vlerat mesatare të mineralizimit të përgjithshëm variojnë  $Mp=351.57-623.15$  mg/l.








Fig.- Mineralizimi i përgjithshëm për akuiferin AL 030, 2007-2011

Përmbajtja e amoniakut  $NH_4$ : nuk tëkohet përmbajtja e  $NH_4$  në fazën e parë dhe në fazën e dytë të monitorimit (norma STASH nuk lejohet, përmbajtja maksimale e lejuar 0.05mg/l, norma e BE-së përmbajtja maksimale e lejuar 0.1mg/l). Përmbajtja e amoniakut për vitet 2007-2011 jepet në fig. nr.22 o krahasuar me standardet e STASH-it dhe BE-së (0-0.05, 0-0.5). Përmbajtja mesatare e amoniakut  $NH_4$  varion 0.003-0.01 mg/l.

Fig. - Përmbajtja e  $NH_4$  për akuiferin AL 030,2007-2011

Përmbajtja e nitriteve  $NO_2$ : nuk tëkohet përmbajtja e nitriteve në Krastë të Vogel e Vidhas në dy fazat e monitorimit. Në shpimin nr.3/70 Krastë e Madhe në fazën e dytë tëkohet përmbajtja 0.01mg/l  $NO_2$ . Në fig. nr.23 jepet përmbajtja e nitriteve në vite. Përmbajtja e nitriteve në ujë të pijshëm nuk lejohet, ndërsa përmbajtja maksimale e lejuar është sipas standardit shqiptar 0.05 mg/l (norma e BE-së është 0.1 mg/l). Përmbajtja mesatare e  $NO_2$  varion 0-0.031mg/l.

Fig. Përmbajtja e  $NO_2$  për akuiferin AL 030,2007-2011

Analiza për mikroelementet janë kryer në Vidhas Elbasan për Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd. Në këto analiza ka përmbajtje të mikroelementeve në dy fazat e monitorimit:  $Ni=0.067-0.036$  mg/l,  $Mn=0.002-0.002$ mg/l,  $Zn=0.018-0.024$  mg/l,  $Pb=0.06-0.06$ mg/l,  $Cu=0.003-0.005$  mg/l,  $Co=0.037-0.055$  mg/l,  $Cr=0.038-0.018$  mg/l,  $Cd=$ ska. Përmbajtja e Pb në dy analizat dhe përmbajtja e Ni në një analizë janë mbi përmbajtjen maksimale të lejuar PML (nl-0.05), ndërsa përmbajtja e mikroelementeve të tjera është në përmbajtjen e rekomanduar deri në PML.

Akuiferi ujëmbajtës zhavorri Lushnjes (viti 2013):

Sasia e ujit që shfrytëzohet nga ky akuifer është 590 - 600 l/sek për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Lushnjes dhe fshatrave.

T - Temperatura e ujit në dy fazat e monitorimit është  $T = 16.4-17.3$  gradë Celsius, tregues brenda normës (norma 8-15, deri 20).

pH i UN- në dy fazat e monitorimit varion 8.45-8.82, nga 8.22-9.13 që variojnë në vitin 2012, sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës deri pak mbi normë por nën kufirin maksimal të lejuar ( $P_h = 6.5-8.5$  dhe 5; 9.5). Sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) janë ujëra të tipit alkalik të dobët me  $P_h = 7-9$ . Ndryshimet në dy fazat e monitorimit variojnë 0.65-0.78. Pëmbajtja mesatare 5 vjeçare varion 8.4-8.63

Fp- Fortësia e përgjithshme në dy fazat e monitorimit varion  $F_p = 13.02-13.860$  gjermane në Divjakë. Në Konjat Cerme fortësia e përgjithshme në dy fazat e monitorimit varion  $F_p = 18.34-26.320$  gjermane, tregues brenda normës së lejuar deri mbi normë Cerme. Në Cerme e Konjat uji është i fortë (norma e ujit të pijshëm është 10-20 grade gjermane dhe maksimale e lejuar 25 grade gjermane). Ndryshimet e Fp në dy fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë nga 0.82-0.84-1.820 gjermane. Pëmbajtja mesatare 5 vjeçare varion  $F_p = 13.66-24.750$  gjermane.

NO<sub>3</sub> -Pëmbajtja e Nitrateve NO<sub>3</sub> në dy fazat e monitorimit është e vogël, ajo varion 0.08-1.97 mg/l, sasi kjo brenda normës së lejuar. Ndryshimet e NO<sub>3</sub> në dy fazat e monitorimit janë të vogla, ato variojnë 0.08-0.21-0.59 mg/l.

NO<sub>2</sub> – Në fazën e parë të monitorimit nuk takohet pëmbajtje e nitriteve në tre shpimet. Në fazën e dytë të monitorimit takohet pëmbajtje e nitriteve në Divjakë dhe Konjat në sasinë 0.01 mg/l. Gjithashtu në fazën e dytë të monitorimit takohet pëmbajtje e nitriteve në Cerme në sasinë 0.05 mg/l, pëmbajtje kjo brenda normës (kufiri max i lejuar 0.05mg/l). Kjo lidhet me mcs zbatimin e zoneve të mbrojtjes sanitare.

Analiza për mikroelemente - Analiza për mikroelemente janë kryer në shpimin 1D Divjakë në Cerme për Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd. Në këto analiza ka pëmbajtje të mikroelementeve në dy fazat e monitorimit: Ni=0.004-0.005mg/l, Mn=0.009-0.006mg/l, Zn=0.01-0.014 mg/l, Pb=0.016-0.06 mg/l, Cu=0.006-0.003mg/l, Co=0.037-0.004 mg/l, Cr=0.062-0 mg/l, Cd=0-0.002mg/l. Pëmbajtja e Pb dhe Cr është pak mbi PML. Pëmbajtja e mikroelementeve është në pëmbajtjen e rekomanduar

### 3.3. Zona ne vleresim

Ne kete zone takohen ujerat nentokesor ne depozitat zhavorr. Niveli i ujit nentokesor eshte 3.80m nga siperfaqja e tokes por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8 m thellesi dhe ne varesi te silnes niveli i tyre ndryshon. Pasqyra e nivelit te perhershem te ujerave nentokesor luhaten sipas reshjeve.

Ne zonen ku do te realizohet projekti verehet se nuk ka burime siperfaqesore ne distanca le aferta. Ne zonen e shfrytezimit dhe pameth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare etj. Ne konturin anesor te zones dhe ne pjesen lindore te prones ne studim vihet re ish kanalet e drenazhimit qe kane ekzistuar per keto toka are. Ne kete rajon ndodhen dy lumenj te vegjel, Dargi ne Jug dhe Leshniqe ne Veri ne distanca te largeta nga prona ne vleresim.



#### 4. IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA,

##### 4.1. Ndikimet e mundshme mjedisore

Mjedis është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm; kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë tërthorë/të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky projekt në teresi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në dy prej fazave kryesore siç janë: faza e montimit të panelave sandwich (ndertimit të strukturave blaja) dhe faza e operimit si magazine. Nuk marrim në konsiderat fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky projekt do të vazhdojë të jetë e tillë e pas shumë e shumë kohe. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga projekti që do të implementohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme nga ky raport VNM-je. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga non-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

##### Ndikimet kryesore

*Në cilësinë e ajrit:*

**Faza e montimit/ndertimit:** Gjate kësaj faze nuk do të ketë ndikim të lartë mbi cilësinë e ajrit pasi montimi i instalimeve ku do të kërkohej të ndërtohet objekte civile por vetëm montohet panela sandwich në kantierin ku do të ushtrohet veprimtaria.

**Faza e operimit:** Ndikimet kryesore në këtë fazë do të shkaktohen nga:

- Nga pajisjet operuese gjate venies në punë të instalimeve janë:
  - Makineritë operuese ngarkim-shkarkimit mund të shkaktojnë shpërndarjen e pluhurave në atmosferë dhe uljen e cilësisë së ajrit përreth, të cilat shkaktohen nga prerja e lëndës. Përreth këtyre makinerive krijohen shtellunga me pluhur, prandaj këtu janë vendosur ventilator për thirrjen e këtij pluhuri në këto magazine për magazinim të dyshekeve, lëndës së parë, etj.
  - Emetimet në ajër mund të shkaktohen nga gazrat e motoreve me djegie të brendshme të makinerive transportuese të ngarkimit-shkarkimit-e levizshme-elektromotorret apo nga gjeneratori (me rëndësi emetimi i Pb-it nga motore me lëndë djegëse benzine apo squfer nga lëndët djegëse naftë). Si rezultat i qirimit të gazeve të makinerive të ndertimit ngarkues-shkarkues të levizshme që do të jenë gjithmonë prezent në këtë kantier.



- Nga punimet ne kantier;
  - Gjate depozitimit te mbetjeve te venddepozitim mund te shkaktojne shperndarjen e pluhurave ne atmosfere dhe uljen e cilesise se ajrit ne kete kantier gjate ndertimit nese do te vleresohet e domosdoshme.
  - Gjate transportimit te mbetjeve te ndertimit ne pika e caktuara do shkaktoj ndotje ne nivele te moderuar ne rruget qe do te pershkojne keto mjete.

Disa faktore natyror qe mund te ndikojne ne rritjen e impaktit ne ajer do te jene si; era, reshjet e shiut, klima e thate. Duke qene se zona perreth eshte e mbrojtur nga kodra, era nuk do te ndikojne ne nivele te larta ne ngritjen e pluhurave vecanerisht ne stinet e thata. Ndersa personat pergjegjes per kantenin mund te ndikojne ne cilesine e ajrit nese nuk respektojne dhe nuk marrin masat e duhura per minimizimin e ketyre efekteve. Ne termat e ndikimeve ne shendet, ndotesit kryesore jane;  $\text{NO}_2$  dhe  $\text{PM}_{10}$ ,  $\text{CO}_2$  etj.  $\text{NO}_2$  mund te kontribuojne ne depozitim rrajonal te acidit por ndikimi i ketij projekti ne krijimin e shiut acid eshte ne nivele te paperfillshme. Ju shtohen ketyre ndotesve dhe gazrat e qiruar nga motoret e automjeteve qe leshojne dyoksid karboni ( $\text{CO}_2$ ) dhe nje perberje te pakte te oksidit te azotit  $\text{N}_2\text{O}_2$ . Keto lloj emetimesh nuk parashikohet te jene shume te ndryshme nga procesi i zakonshem dhe efektet parashikohet te jene te kthyeshme dhe te perkohshme.

Emetimet ne ajer u theksua me siper qe do te prodhohen nga djegia e lendes djegese por mund te themi se niveli i shkarkimeve do te jete i ulet, pra ne nivele te paperfillshme, kjo vjen si rezultat se mjetet rugore apo te transportit qe do te perdoren do te jene konformi normave te percaktuara ne Udhhezimin Nr 6527, date 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rugore dhe menytrat e kontrollimit te tyre"

Do te kemi shkarkim te ndotesve te tjere ne ajer nga burime te tjera sic jane gjeneratoret qe do te perdoren gjate mungeses se energjise elektrike, si dhe ndotje termike nga makinerite e kotij impinati gjate oreve te punes.

Tabele 1. Analiza matricore e ndikimeve ne ajer.

Ndikime ne cilesine e ajrit	Identifikimi i ndikimeve		Vleresimi i ndikimeve
	Mungese	Prani	
Proxim i pluhurave LGS, $\text{PM}_{10}$		X(2)	-1
Ndotja nga lendet djegese ne permasa te ndjeshme	X(1)		0
Emissionet e $\text{CO}_2$ dhe $\text{SO}_2$	X(1)		0
Ndikim ne mikroklimen	X(2)		0
Total			-1

Sqarim: (1) Te dy impaktet varon nga perdorimi i lendes djegese, megjithese zona eshte e hapur dhe ku deri diku fryne ere e lehte

(2) Ky impakt nuk preke banoret por vetem punonjesit ne kete kantier.

#### *Vibrimi dhe zhurma.*

**Faza e ndertimit:** Gjate ndertimit do te ndikohet ne rritje te nivelit te ndotjes akustike, por ndikimi i tyre do te jete i perkohshem. Do te shkaktohet zhurme dhe gjate ndertimit te pajisjeve te nevojshme per kete projekt.

**Faza e operimit:** Disa burime qe do te shkaktojne zhurmat dhe vibrimet jane te paraqitura ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Si pasqja e punes se mjeteve te ngarkimit dhe te transportit te produkteve ushqimore: Ndikime nga zhurmat do te shkaktohen nga makinerte sic mund te jene kamionet, etj. Do te shkaktohet ndotje akustike dhe nga mjetele e transportit sic jane kamionat qe transportojne materialet e nderimit, etj.
- Te shkaktohet nga prania e punonjeseve ne kantier: Prania e punonjeseve do te kete ndikim ne mrije te nivelit te zhurmave nga bisedat e tyre sidomos gjate oreve te nates. Ndikimi i tyre do te jete teper i ulet.
- Te shkaktohet gjate kalimit te mjeteve te tonazhit te larte: Do te ndihen vibrime ne mjedisin aty prane. Do te shkaktohen vibrime dhe nga kamionet.

Gjate nderimit do te ndikohet vetem ne jeten e punonjeseve te nderimit dhe si dhe ne mjedis prane sheshit te nderimit, por ndikimi do te jete ne nivele te ulta pasi makinerte jane te projektuar konform Standarteve Evropiane.

Tabele 2 Analiza matricore e ndikimeve nga zhurmat/vibrimet.

Ndikimet nga zhurmat dhe vibrimet	Identifikimi i ndikimeve		Vleresimi i ndikimeve
	Mungese	Prani	
Kalimi ne zona te banuara		X(1)	-1
Trafiku dhe perdorimi i makinave te renda gjate punimeve		X(1)	-1
Nga impianti dhe makinerte qe do instalohen		X(1)	0
Totali			-2

Shpjegim: (1) Ky impakt do te preke ne pergjithesi te gjithe seksionet e perfshira ne projekt.

Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma qe shkaktohen ne nje kantier i punes, mund te theksojme faktin se ndotja akustike do te jete ne nivele me te ulta pasi ne kete magazino nuk do te ndertohet asnje objekt civil. Zhurma pritet te jete e moderuar por e perkohshme pasi ne kete impiant do te aplikohen teknologji me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa mrije te shpenzimeve operative. Matjet shkencore kane treguar nje ulje prej te pakten 35-40% te nivelit te impaktit te vibrimeve dhe te zhurmave.

Zhurmat e tjera qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga mjetet rugore qe do te kalojne prane rruges nacionale si dhe nga perdorimi i pompave te ujit, gjeneratorit, etj. Montimi i pareteve te makinerve me materiale akustike do te sjell ndikim pozitive ne uljen e ndoljes akustike ne mjedisin perreth. Mjetet e qarkullimit rugor do te jene konform kushtave teknike ne perputhje me ligjin ne fuqi, (odo vit mjeteve rugore ne Shqiperi u behet kontrolli teknik dhe per nivelin e zhurmes qe shkaktojne mjetet e qarkullimit dhe pajisen me pulle te posatshme).

Nuk do te shkaktohet ndotje akustike te mjedisve te banuara pasi ato ndodhen larg zones se nderimit te kantierit.

Ne toke.

**Faza e nderimit:** Keto proces nuk do te ndikojne negativisht ne toke dhe as ne dhe, kjo vjen si rezultat se gjate nderimit te njesive ftohese nuk do te ushtrohen veprimtari qe kane lidhje me ndryshime te tokes apo dheut pasi ky impiant vetem montohet ne terren sipas njolles se objektit me konstruksion metalike.

**Faza e operimit:** Disa ndikime kryesore ne toke jane:



- *Ndikime nga efekti i erozionit:* Kjo zone nuk ka predispozim të theksuar për erozion në sipërfaqe, është në nivele të papërfillshme pasi territori është i rrafshët. Ky fenomen nuk do të haset gjatë operimit.
- *Ndikimet fizike të projektit me ndryshime topografike lokale:* Gjatë shfrytëzimit nuk do të ketë ndryshime të mëdha në topografinë lokale pasi në përgjithësi sheshi është i rrafshët dhe nuk do të bëhet nivelim i sheshit të ndërtimit. Në projekt është parashikuar një radhë dhe drejtim i tillë shfrytëzimi, që në kombinim me masat e tjera suplementare si të mbushjes, sistemit dhe trajtimit, parandalojnë ndryshime topografike. Sheshi përreth do të shtrihet me beton të cilësive përkatëse ku do të lihen hapësira të rrafshueshme për brezat e gjelbra si dhe për rrugë kalimi të mjeteve të tonazhit të rëndë/vend parkim/ shesh për depozitimin e mbetjeve për tu ripërdorur përseri në impiant, vend për depozitat e ujit, etj.
- *Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve në tokë dhe rrethina:* Impianti parashikon vetëm shfrytëzimin të panelave sandwich për prodhim të elementeve, nuk ka derdhje apo shkarkime të ngurta ose të gazta në ambient të elementeve kimik ose të tjerë element të demshëm apo të rrezikshëm për mjedisin në permassa të ndjeshme për mjedisin. Ndikim nga lëndet djegëse mund të shkaktohen vetëm në rastet e carjeve të serbatorit të mjeteve të ndërtimit, apo pikimeve të tyre gjatë qarkullimit në kantierin e punimeve.
- *Ndikimet në përdorimin e tokës dhe të burimeve në cilësi dhe sasi të tokës bujqësore:* Sipërfaqja që do të nënshtrohet shfrytëzimit ka qenë tokë e llojit arë, por prej shumë vitesh është tokë e lenë djemë. Zone në studim nuk është zënë nga ndërtime apo objekte banimi të cilat ndodhen në distanca të largëta. Ndikimi në këtë sipërfaqe, nuk ndikon negativisht në cilësi dhe sasi të tokës bujqësore sepse tokë e kësaj zone e ka koeficientin e humurit të ulët e dila çon në një rendiment të ulët të kësaj zone për kultivime bujqësore me kapacitet të lartë sic vërehet edhe në foto.
- *Ndikimet e projektit në modelin drenazhues të zonës:* Projekti i parashikuar nuk ndikon në modelin e drenazhimit se nuk ekzistojnë vepra drenazhimi në zonën e projektuar përreth zonës, në kufirin pranë kësaj zone ndodhet vetëm një segment i vogël i një kanali ekzistues për kullimin e ujerave që mbidheshin nga këto sipërfaqe të tokës. Ky kanal nuk është në gjendje të mirë pasi nuk është kujdesur askush për pastrimin e tij nga lumenjtë që vijnë së bashku me prurjet nga reketë ujore të kësaj zone. Në këtë zonë nuk do të ndikohet në rrjetin e drenazhimit pasi uji që do të përdoret për larjen e mjediseve është i cilesi për konsum, kjo lidhet ngushtë me vetë faktin se uji duhet të jetë pa përberje kimike për të shmangur veprimin me lëndet inertë, mbetjet e lëngjave ujore që do të prodhohen nga larja e mjediseve do të derdhen në rrjetin e kanalizimeve të ndërtuar në këtë kantier dhe do të depozitohen në një rezervuar dekantues të pajisur dhe me një rezervuar fillestall për të ndarë ujën nga vajrat apo lëndet fosile që mund të prodhohen nga makineritë e impiantit, ku më pas do të largohen nga zona me anë të autoboteve dhe do të shkarkohen në një mjedis prites që ka të njëjta parametra, pra vendi ku do të shkarkohen këto ujera do të përcaktohet nga institucionet përgjegjëse për këtë veprimtari. Ndërsa në rastet e avarive nuk do të ndikohet sepse do të përdoret rrjeti rezervë i emergjencave (do të ndërtohet vetëm kur të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme dhe do të përcaktohet nga investitori).

Tabela 3. Analiza matricore e ndikimeve në tokë.

Ndikime në tokë	Identifikimi i ndikimeve		Vlerësimi i ndikimeve
	Mungese	Prani	
Erozioni i tokës	X(1)		0
Fjerrsi të papërdurueshme	X(1)		0
Kompaktimi i tokës	X		0
Nga derdhjet/pikimet e mjeteve rrugore dhe të ndërtimit		X(2)	-1



Ne sistemin e drenazimit te zones	X	0
Totali		-1

Sqarim: (1) Erozioni i tokes nuk eshte i pranishem ne kete zone fushore.

(2) Ky eshte rasti i lendeve djegese si vaj, benzine, nafta, graso, etj te cilat do te vijne nga mjetet e ndertimit dhe nga makinerite e transportit.

Ne ujerat nentokesore-siperfaqesore:

**Faza e ndertimit:** Nga realizimi i ketij projekti nuk do te ndikohet ne ndotje te ujerave nentokesor pasi ka veprim ndertimor sipas konstruksionit metalik qe mund te ndikoj ne te.

